



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 15.04.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 08.04.2024, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "IZO - H" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Molerimi i shkollave", Nr. i prokurimit-632-24-1759-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-020-221, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Operatori Ekonomik "IZO - H" SH.P.K. e dt.08.04.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Molerimi i shkollave", Nr. i prokurimit- 632-24-1759-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-020-221, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 04.04.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 04.04.2024;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "IZO - H" SH.P.K. me dt.08.04.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit "Molerimi i shkollave" , Nr. i prokurimit- 632-24-1759-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-020-221..

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 15.04.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj i parë nuk qëndron , sepse:

- Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, Deklaratën nën betim, e ka plotësuar, nënshkruar dhe vulosur, siç është kërkuar në FDT-ë;
- Specifikimet teknike të detyrueshme janë plotësuar siç është kërkuar në FDT-ë;
- Pretendimi juaj se Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka paraqitur deklaratë mbi planin dinamik , nuk qëndron, sepse kjo është kontratë kornizë dhe te kontratat kornizë një gjë e tillë nuk kërkohet;

Pretendimi juaj i dytë, lidhur me atë se diplomat e inxhinierëve nuk janë origjinale apo të noterizuara dhe se në CV nuk kanë referenca, nuk qëndron , sepse në FDT-ë nuk është kërkuar një gjë e tillë:

Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 10 (dhjetë) punëtorë të mjaftueshëm si dhe të ketë staf profesional për kryerjen e projektit a.) një inxhinier i diplomuar apo master i ndërtimtarisë - drejtimi konstruktiv me pesë vite përvojë pune pas diplomimit, b.) një inxhinier i diplomuar apo master i arkitekturës me pesë vite përvojë pune pas diplomimit.

Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj profesional të dëshmohet me CV, diplomë dhe kontrata e punës apo në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë, si dhe lista e numrit të punëtorëve të angazhuar me të dhënat në vijim emri, mbiemri i e punëtorit, profesioni, dhe pozicioni në kompani.

Pretendimi juaj i tretë nuk qëndron, sepse Autoriteti kontraktues ka kërkuar së paku një referencë ose raport të pranimit të shërbimeve:

Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme për tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.

Lista e kontratave në të cilën specifikohen të gjitha shërbimet e realizuara në 3 (tri) vitet e shkuara, duke saktësuar shërbimet e kryera shumë e kontratës, datën e pranuesit ose certifikatën e ekzekutimit të mirë të shërbimeve – (së paku një referencë ose raport të pranimit të shërbimeve e cila përputhet me listën e dorëzuar)


Gjithashtu ju qartësojmë se Autoriteti kontraktues, në FDT, ka kërkuar qarkullim bankar 100,00.00€ për vitet 2021,2022, dhe 2023 dhe së paku një referencë ose raport të pranimit të shërbimeve e jo kontrata të realizuara në këtë vlerë, siç pretendoni ju, prandaj edhe ky pretendim nuk qëndron.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Faton Gutaj


Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

